

VENDIM
Nr.741, datë 1.7.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR.1, TË MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË ZHVILLIMIT TË RRUGËVE, NË BASHKINË E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1, të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të zhvillimit të rrugëve, në bashkinë e Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE NDRYSHUESE NR. 1
PËR MARRËVESHJEN E HUASË TË DATËS 30 QERSHOR 2006
(PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E RRUGËVE TË BASHKISË SË TIRANËS)

Kjo marrëveshje ndryshuese, e datës 2009, përfundohet nga dhe ndërmjet:

(+)1. Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”); dhe

(+)2. Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, organizatë ndërkombëtare e themeluar me traktat (“BERZH”).

Duke marrë parasysh se:

A. Huamarrësi ka lidhur një marrëveshje huaje të datës 30 qershor 2006 (“Marrëveshje Fillestare e Huasë”) me BERZH-in, në bazë të së cilës BERZH-i ka rënë dakord t’i japë një hua Huamarrësit në shumën 14 600 000 euro (“Huaja”), me afatet dhe kushtet e parashikuara në Marrëveshjen Fillestare të Huasë, për të asistuar në rehabilitimin dhe zhvillimin e rrugëve në Bashkinë e Tiranës (“Projekti”);

B. Bashkia e Tiranës (“Njësia e Projektit”) ka lidhur një marrëveshje projekti të datës 30 qershor 2006 (“Marrëveshja e Projektit”) me BERZH-in, sipas së cilës Njësia e Projektit bie dakord të marrë përsipër disa detyrime të parashikuara në të;

C. Huamarrësi ka lidhur një marrëveshje huaje shtesë të datës 4 shtator 2006 me Njësinë e Projektit, sipas së cilës Huamarrësi ka rënë dakord t’i ofrojë Njesisë së Projektit një pjesë të shumës së huasë për qëllimet e zbatimit të pjesëve të caktuara të projektit;

D. Me anë të letres së datës 27 tetor 2008, Huamarrësi i kërkoi BERZH-it të ndryshojnë Marrëveshjen Fillestare të Huasë për të rishikuar pjesën 4 të përshkrimit të projektit dhe të kalojë 1,100 000 euro nga kategoria (4) në kategorinë (6) të projektit;

E. Me letren e datës () 2009, Huamarrësi i ka kërkuar BERZH-it të shtyjë Datën e Fundit të Vlefshmërisë (sipas përcaktimit në Marrëveshjen Fillestare të Huasë); dhe

F. Huamarrësi dhe BERZH-i duan të ndryshojnë Marrëveshjen Fillestare të Huasë në disa aspekte, sipas dhe në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Për më tepër, duke pasur parasysh sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Formatted: Bullets and Numbering

Seksioni 1. Përfshirja e afateve dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të BERZH-it të datës 1 maj 2006 përfshihen dhe bëhen të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtin efekt dhe fuqi sikur të ishin përfshirë këtu (këto dispozita këtu quhen “Termat dhe Kushtet Standarde”).

Seksioni 2. Përkufizime

a) Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë pjesën hyrëse dhe grafikët), nëse nuk përcaktohet ndryshe apo nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e përkufizuar në pjesën hyrëse kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre, termat e përkufizuar në termat dhe kushtet standarde dhe Marrëveshjen Fillestare të Huasë kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Ndryshime” janë ndryshimet e bëra ose që duhet të bëhen në pajtim me seksionin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

“Marrëveshje e ndryshuar” është Marrëveshja Originale e Huasë, të ndryshuar me këtë Marrëveshje.

“Datë e hyrjes në fuqi” ka kuptimin e dhënë në seksionin 5 të kësaj Marrëveshjeje.

b) Marrëveshja Fillestare e Huasë dhe kjo Marrëveshje lexohen dhe interpretohen si një dokument i vetëm.

Seksioni 3. Ndryshimet

Me fuqi në dhe nga dita e hyrjes në fuqi, Marrëveshja Fillestare e Huasë ndryshohet me ndryshimet e përcaktuara më poshtë.

a) Seksioni 2.02(f) i Marrëveshjes Fillestare të Huasë

Seksioni 2.02(f) i Marrëveshjes Fillestare të Huasë ndryshohet duke hequr datën “31 dhjetor 2008” që është në të dhe futja në vend të saj e datës së mëposhtme:

“31 dhjetor 2010”.

b) Programi 1 i Marrëveshjes Fillestare të Huasë

Seksioni 2 i Programit 1 të Marrëveshjes Fillestare të Huasë ndryshohet duke hequr nëndispozitën A-4 që është në të dhe futja në vend të saj si më poshtë:

“A-4: Rindërtimi dhe zgjerimi i Urës së Lanës pranë Shkollës Teknologjike dhe ndërtimi i Qendrës së Kontrollit të Trafikut në Bashkinë e Tiranës”

c) Shtojca në programin 2 të Marrëveshjes Fillestare të Huasë

Shtojca në programin 2 të Marrëveshjes Fillestare të Huasë ndryshohet duke kaluar 1 400 000 euro nga kategoria (4) në kategorinë (6), si më poshtë:

Kategoria	Shuma e rialokuar	Shuma e rishikuar në euro e alokuar në kategori
4) Mallra, punime dhe shërbime për pjesën A-4 të projektit	- 1,400,000 euro	1,100,000 euro
6) Pajisje për pjesët A-1, A-2, A-3 dhe A-4 të projektit	+ 1,400,000 euro	1,900,000 euro

Seksioni 4. Vazhdimësia dhe pëlqimi

Dispozitat e Marrëveshjes Fillestare të Huasë, përveç kur ndryshohen nga kjo Marrëveshje, vazhdojnë të mbeten në fuqi.

Seksioni 5. Data e hyrjes në fuqi

Data e hyrjes në fuqi është data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi dhe

BERZH-i.

Seksioni 6. Të ndryshme

a) Të gjitha referencat në “Marrëveshjen e Huasë” në Marrëveshjen Fillestare të Huasë dhe të gjitha referencat në Marrëveshjen Fillestare të Huasë në të gjitha instrumentet dhe marrëveshjet e nënshkruara në pajtim me të i referohen Marrëveshjes Fillestare të Huasë me ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje.

b) Kjo Marrëveshje dhe dokumentet e referuara në të përbëjnë një detyrim të plotë të palëve në të lidhje me objektin e saj dhe kanë prioritet çdo shprehje të mëparshme të interesit ose të mirëkuptimit në lidhje me objektin e tyre.

c) Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me një instrument me shkrim të nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës prej palëve në to.

d) Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në disa kopje, secila prej të cilave konsiderohet të jetë origjinale por të gjitha ato përbëjnë të njëjtën marrëveshje.

Seksioni 7. Ligji i zbatuar dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për shmangien e dyshimit, dispozitat e seksionit 8.04 të termave dhe kushteve standarde përfshihen nëpërmjet kësaj reference dhe bëhen pjesë e kësaj Marrëveshjeje sikur të parashtrohej këtu plotësisht, *mutatis mutandis* dhe (pa cenuar përgjithësimin e tyre) sikur referenca në të për “Marrëveshjen e Huasë” të ishte për këtë Marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuese të tyre të autorizuar rregullisht kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në katër kopje dhe dorëzuar në Londër, Angli në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga _____

Emri:

Titulli: Ministri i Financave

BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM

DHE ZHVILLIM

Nga _____

Emri:

Titulli: